



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 13/2011
Prishtinë, më 02.06.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Biserka Kostić dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka dhe Ramiz Kelmendi.

Të ftuarit për raportim: Ekrem Hoxha, Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe Visar Halimi, udhëheqës i departamentit të menaxhimit të frekuencave në ART.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi - ZPRK; Haxhi Gashi-USAID/ Deloitte; Fitim Salihu dhe Ganimete Heseti – KDI; dhe Sanije Berisha - OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 24 dhe 25.05.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme;
4. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 25. 05. 2011

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 24 dhe 25.05.2011 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme

Kryetari – tha që për këtë Projektligj raportuese është znj. Teuta Sahatqija, dhe ia kaloj fjalën për të paraqitur Raportin me propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme.

Teuta Sahatqija - tha së Grupi punues ka shqyrtuar këtë projektligj, dhe është takuar disa here, dhe kemi pasur një bashkëpunim të mire më përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Projektit të USAID/BEEP, Komisionit Evropian dhe më Njësinë mbështetëse të Komisionit. Theksoj së gjate shqyrtimit për amendamentin e projektligjit kemi hasur në vështersi të shumta, ku në rend të parë ligji ekzistues dhe projektligji për ndryshim nuk janë të sistemuar mire, nuk është i standardizuar, ekziston një kolizioni në mesë të inspektorateve, sepse është ligji për inspektoratin që e rregullon këtë fushë. Dhe ka përzierje të kompetencave me ligjet tjera si me ligji për shoqëritë tregtare dhe ligjin për mbrojtjen e konkurrencën. Andaj ne qoftë se dëshirojmë ta krijojmë një ambient me të mirë për biznes, atëherë duhet dhe një herë ta shikojmë mire këtë projektligj. Dhe kërkojmë nga qeveria dhe ministrit përkatës që kur të na sjellin në Kuvend për shqyrtim projektligjet të jenë të strukturuar dhe të standardizuar mire, që mos jenë ndesh me ligjet e tjera. Ne si Grup punues kemi diskutuar që jetë edhe një takim më përfaqësuesit MTI-së që ti marrim sqarimet shtesë.

Kryetari- propozoj që ta kemi edhe një takim znj, Mimoza Kusari- Lila, ministër Tregtisë dhe Industrisë, dhe me partneret që na përkrahin, dhe që ti marrim sqarimet e nevojshme lidhur me kolizionet e panevojshme që u ngritën nga grupi punës.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

1. Shtyhet Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente te Projektligjit nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme;
2. Në mbledhjen e radhës të ftohet Ministria e tregtisë dhe industrisë, në cilësinë e sponsorizuesit të arsyetoj projektligjin.

4. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor.

Kryetari - theksoj se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Plani kombëtar i shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor, që e ka hartuar ART- ja. Ne kemi ftuar kryetarin e Bordit z. Hoxha, i cili do të paraqet një ekspozë të shkurtë për këtë plan kombëtar e cila është një temë shumë profesionale.

Ekrem Hoxha (Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART-së) – tha që Plani kombëtar i shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor praqet një të arritur shumë të madhe në aspektin profesional. ART-ja derë tani ka punuar me një plan UNMIK-ut dhe ka qene sfidë për ART-ën. Plani bazën ligjore e ka të Ligji i telekomunikacionit të neni 63 dhe për këtë arsyeje ju kemi drejtuar komisionit funksional që ta paraqes miratim për seancë plenare, dhe që ti mundësojë ART-së që ta përgatit dokumentacionin sekondar për të funksionuar sa ma mire të kërkesit e frekuencave së për çfarë lloje teknologji duhet me kërkuar prej tyre. Për ART-ën ka qene një sfidë në veti për ti krijuar këto tabela për grupet e interesit. Këto kompetenca kanë qene të NATO-s konkretisht në menaxhim të KFOR-it. Theksoj së ky plan është 5 vjeçar dhe ne këtë drejtim na ka ndihmuar shumë KFOR-i për ti akomoduar shpërndarjen e spektrit radiofrekuencor. Në aspektin e sigurisë dhe kjo do t'i shërbeje edhe FSK-së për të ardhmen. Kjo tabelë kombëtare është në përputhje me Direktivat e Komisionit Evropian, ku na kanë rekomanduar se si jepen Direktivat për brezin frekuencor për çdo kanal. Për këtë kemi pas këshillim publik për 30 dite edhe këtë kemi pranuar komente dhe janë organizuar seanca dëgjimoe janë mbajtur debate të rregullta me operatorët që kanë qene te interesuar, për te ju shpjeguar bazën ligjore, dhe mënyrën e përdorimit që të mos keqpërdoren. Andaj, e sigurojmë Kuvendin, që plani është punuar në mënyrë shumë profesionale dhe siguron të gjithë investitorët e mundshëm dhe operatorët që e ka bazën ligjore të Ligji për telekomunikacion dhe përmes këtyre tabelave.

Kryetari - pyeti se cilët janë grupet e interesit të spektri i sigurisë, dhe a keni rregulluar mirë çështjen e spektrit të sigurisë me KFORI-n? Për transferimin e kompetencave të vendoret dhe sa është akomoduar spektrit radiofrekuencor?

Ekrem Hoxha (Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART-së) - Tha që ne grupet e interesit janë operatorët e mëdhenj që i shfrytëzojnë frekuencat tona, dhe operatorët e mëdhenj janë: Poste Telekom i Kosovës operator i parë VALA, IPKO, KUJTESA dhe ARTMOTION. Këta janë operatorët me të mëdhenj, grupe tjetre interesit ka qene KPM-ja. Ndërsa të sektorit publik janë ministria e Administratës Publike dhe Policia që i menaxhojnë rezervat e frekuencave që kanë licencë nga ART-ja. Një nder sfidat që kemi pas gjatë hartimit në këtë plani ka qene keqkuptimi në mes të ART-së dhe KPM-së lidhur me përgjegjësit e frekuencave radio-difuzive të cilat do ti përdorin ata për operatorët e tyre. Mirëpo është arritur një marrëveshje mirëkuptimi për këtë çështje. Theksoj së ne me këtë Plan kombëtar të shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor kemi bërë ndarjen e frekuencave militare apo ushtarake, kjo shpërndahet nga ana e KFOR-it për nevojat ushtarake dhe edhe civile që shërben vetëm për nevojat komerciale. Ndërsa sa përket sigurisë së frekuencave kjo është e rregulluar mire dhe ka një siguri. Dhe a janë akomoduar spektret radio-frekuencor, tha që mendojmë që po. Për transferimin e kompetencave ne mendojmë që pas aprovimit të Planit nga ana e Kuvendit atëherë i hapet rruga marrjes së kompetencave vendore, për atë KFORI ka qene shumë rezistent së pa marrë pëlqimin nga Kuvendit të Kosovës nuk ka transferim të kompetencave.

Myzejene Selmani - pyeti se këtë ky Plan a është nën përgjegjësinë ministrisë së Infrastrukturës, apo ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, apo ART-së? Dhe a është harmonizim i duhur në mes të këtyre institucioneve?

Ekrem Hoxha (Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit-ART-së) - tha që ky Plan është kombëtar dhe është caktuar me struktura të funksionimit, se si do të zhvillohet, dhe me Ligjin e telekomunikacionit në nenin 63 është kompetence e ART-së, ndërsa i mbetet autoritetit rregullator për ti harmonizuar me harmoni me ligjin.

Teuta Sahatqija - tha që është një arritur e mirë për shtetin e Kosovës që ART-ja ka arritur ta hartoj Planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor, dhe po besoj së shumë shpejt

do te merr të gjitha përgjegjësit. Plani frekuencor nuk e benë vetëm shpërndarjen e frekuencave, por e bene edhe përcaktimin vijave se ka do të ecet me këtë planë duke udhëzuar operatorët për pajisjet e tyre që duhet ti kanë për funksionim në shtetin e Kosovës. Pyeti se KFOR- i që e benë alokimin e frekoekcave militare, a benë shpërndarjen e frekuencave për FSK-ën, apo është kompetencë e ART-së? Dhe më çfarë mënyre behët shpërndarja e fuqive të transmetuesve? Për brezat pa licencë në spektrin amator cilat janë ato breza? A ekziston limitimi i shpërndarjes së fuqisë në ato breza? Në fund tha që mendoj së është specifikuar mirë Plani kombëtar te shpërndarjes se spektrit radiofrekuencor së çfarë lloj pajisje do të keni operatorët që do te licencohen.

Visar Halimi, (udhëheqës i departamentit të menaxhimit të frekuencave ne ART.) – tha që KFOR-i brezat cilat i alokon, ka brez të caktuar civil që duhet marr nga KFOR-i, por ka breza frekuencor të cilat policia edhe FSK-ja i merr prej ART-së, brenda një brezi 1 deri 100 kanale frekuencore. Prandaj tabela e alokimeve për operatorët i ka të ndarë brezat nen brezit për kanalet frekuencore, p.sh KFOR-i benë shpërndarjen me teknologji shumë ma të madhe dhe të avancuar. Pra FSK- ja ka vazhdimisht kërkesa për nevojat e saj i benë kërkesat të ART- ja dhe ne ju drejtohem KFOR-it nuk kemi pas pengesa deri me tani në këtë drejtim sepse pajisjet e tyre kanë siguri shume më të madhe, shume pjesë të ati brezi do të jenë në kompetenca të FSK- së por ka pjesë te brezit civile të cilat frekuencat dhe kanalet që marrin nga ART-ja. Se me cilat mënyra i behet shpërndarja tha që behët më anë të operuesve ajrore, dhe për brezin e shpërndarjes tha që atë KFOR- i e ka për sektorin ushtarak edhe për sektorin civil e ka ART-ja. Por ne disa rast ku nuk ka KFOR-i ne disa vend e merr nga ART-ja, dhe çdo operatorë trajtohet me specifikat e veta, duke i shikuar brezat kufitare dhe fuqinë e kanaleve. Sa përket fuqive të pajisjeve ART- ja nuk ka ndonjë ndalës ndaj fuqive të pajisjeve, por ne i përcaktojmë fuqitë varësisht nga territori i shtrirjes. ART- ja për shumë breza do nxjerr rregullore që do të përcaktojnë saktë alokimin e brezave kështu që kjo është pjesë e legjislacionit sekondare. Ky është një orientim gjeneral në harmoni me institucionet ndërkombëtare duke i mare ne konsiderim disa specifika te së cilit shtete. Për shërbimet amatore pa licence tha që ne e kemi një rregullore aty parashikohen brezat më fuqi të ultë dhe rregullore i parasheh në detaj se si të funksionojnë që mos të ndikojnë negativisht në përdorimin e atyre pajisjeve. Në fund tha që ne si ART- do të jemi shume më të kujdesshme në fuqinë e tyre sepse ne kemi përgjegjësinë që operatorët të jenë të kënaqur më ofrimin e shërbimeve.

Hashim Deshishku - pyeti për faqen 84 -86 ku është cekur dhe në shumë faqe përdorën emri Jugosllavi, tani dihet që nuk ekziston ky shtet, mos është ndonjë gabim teknik apo si qëndron puna?

Visar Halimi, (udhëheqës i departamentit të menaxhimit të frekuencave ne ART)- tha që këto janë fusnota që ne kemi marre nga institucionet ndërkombëtare. Për ART-n është problematike me ndërhyrë në fusnota dhe është një dokument që nuk kemi të drejtën me ndërhyre në origjinalitetin e tij.

Visar Ymeri - pyeti se ky Plan kombëtarë a ka implikim në çështjen e Kodit të telefonisë shtetërore dhe për operatorët ilegale që veprojnë në territorin e Kosovës?

Visar Halimi, (udhëheqës i departamentit të menaxhimit të frekuencave ne ART) - Theksoj që ky plan për atë edhe quhet Planë kombëtarë dhe do të shfrytëzohet ne territorin e Kosovës, dhe ky është dokument më të cilin ju tregojmë shteteve tjera së ky është resurs i vendit. Prandaj ne marrim përgjegjësin për shpërndarjen e alokimeve në tërë territorin e Kosovës dhe për çdo shërbim. Nuk ka implikim ne Kodin e telefonisë shtetërore sepse ato shërbime shkojnë me tjetër metode.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Plani kombëtar i shpërndarjes së spektrit radiofrekuencor.

5. Të ndryshme.

a) Mbledhja e radhës

Kryetari – propozoj që në mbledhjen e radhës si pike rendit të ditës të jetë: Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente të Projektligjit nr.04/L-014 për efikasitetin e energjisë dhe Raportin me propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme.

b) Aktivitetet e radhës të Komisionit;

Kryetari – Kërkoj nga stafi i Komisionit, që në bazë të Planit të punës për javën ardhshme të ftohet z. Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit ekonomik në takim që të raportojë në Komision për punën dhe aktivitetin e ministrisë që drejton.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit**